



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në pajtim me dispozitat e nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L - 040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të dispozitave të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L -106, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor, nr. 2003/14, të dispozitave të nenit 33, pika 33.2, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 29.12.2011, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R
NDRYSHIMIN E PROJEKTPLANIT STRATEGJIK - ZHVILLIMI URBAN I
PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin e Vendimit për miratimin e projektplanit strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës, 01. nr. 031 - 1231, i dt. 27.05.2004

Neni 2

Kuvendi i Komunës autorizon ekzekutivin e Komunës, Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, , që të bëjë ndryshimin në planifikimin e koeficientit të ndërtimit në propozimplanet rregulluese, të propozuara për miratim Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Kuvendi i Komunës me rastin e marrjes së vendimit lidhur me miratimin e planeve rregulluese urbane, do të zbatojë dispozitat e këtij Vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 35-3201. dt 29.12.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.